



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore të Salih Mustafës, Paneli i Apelit, më 10 shtator, shpalli dënimin e ri me 15 vjet burgim, ku llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, si rezultat i verdiktit të fajësisë për ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje të paligjshme si krime lufte. Paneli i Apelit përsëriti se dënimi i ri nuk zhvlerëson peshën e krimeve për të cilat u dënua z. Mustafa. Vendimi i Panelit të Apelit u lëshua si rezultat i vendimit të Panelit të Gjykatës Supreme më 29 korrik, që miratoi, pjesërisht, kërkesën e z. Mustafa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe shfuqizoi aktgjykimin e apelit në lidhje me dënimin me 22 vjet burgim të z. Mustafa, si dhe ia ktheu çështjen Panelit të Apelit.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, më 5 shtator, Trupi Gjykses miratoi kërkesën e Prokurorisë për të lejuar pranimin në prova të disa pjesëve të dëshmisë me shkrim të një dëshmitari dhe për ta lejuar atë të dëshmojë nëpërmjet videokonferencës. Trupi Gjykses theksoi se Mbrojtja nuk kundërshtoi kërkesën dhe konstatoi se dhënia e dëshmisë nëpërmjet videokonferencës është më e favorshme për mirëqenien e dëshmitarit dhe ndihmon në kryerjen e shpejtë të procesit gjyqësor.

Të njëjtën ditë, Trupi Gjykses miratoi një kërkesë të Prokurorisë që dhe dy dëshmitarë të tjerë të japin dëshmi nëpërmjet videokonferencës, meqë kjo është më e favorshme për shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Trupi Gjykses u bind se dhënia e dëshmisë prej tyre nëpërmjet videokonferencës nuk do t'u shkaktojë dëm të akuzuarve dhe është në përputhje me mbrojtjen e efektshme të të drejtave të tyre.

Më 10 shtator, Trupi Gjykses pranoi në prova dëshmitë dhe provat materiale shoqëruese me shkrim të 9 dëshmitarëve. Trupi Gjykses hodhi poshtë kërkesën në lidhje me dëshmitarin e 10-të, pa paragjykuar të drejtën e Prokurorisë për të paraqitur kërkesë për ta thirrur dëshmitarin të dëshmojë në sallën e gjyqit.

Seanca e ardhshme në këtë çështje gjyqësore është planifikuar për të hënë, 16 shtator, duke filluar në orën 9:00 paradite.

Më 3 shtator, pasi Kryetarja Trendafilova caktoi Trupin Gjykses I në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës*, më 5 shtator, Trupi Gjykses I njoftoi se kanë zgjedhur njëzëri gjykatësen Mapi Feld-Folia kryegjykatëse të Trupit Gjykses për këtë gjykim.

Më 9 shtator 2024, Paneli i Gjykatës Supreme, që përbëhet nga gjykatëset Ekaterina Trendafilova, Kristinë van den Vajngart dhe gjykatësi Daniel Fransen, hodhi poshtë kërkesën e Haxhi Shalës për mbrojtje të ligjshmërisë në lidhje me paraburgimin e tij. Trupi Gjykses konstatoi se nuk kishte pasur asnjë shkelje të





konsiderueshme të procedurës nga ana e Gjykatës së Procedurës Paraprake, e cila urdhëroi fillimisht vazhdimin e paraburgimit të të akuzuarit, dhe as nga Paneli të Apelit i cili e konfirmoi vendimin.

Në çështjen gjyqësore të Pjetër Shalës është planifikuar një konferencë para apelit për të premtën, më 20 shtator. Gjatë seancës, palët pritët të paraqesin parashtrime dhe Trupi Gjykues do të kërkojë përditësime lidhur me ecurinë e përkthimit në shqipe të Aktgjykimit. Dhomat e Specializuara i përkthejnë të gjitha dokumentet dhe parashtrimet e protokolluara publike në të tri gjuhët e gjykatës, shqipe, serbishte dhe anglishte, sa më shpejt që është e mundur.

